

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbim

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: Shpenzime për blerje biletash të transportit ajror ndërkombëtar.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Bileta transporti : 34980000-0

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Korçë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1.KRITERET E PËRGJITHSHME/VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi i shpallur fitues duhet të dorëzojë:

- Rezervimin e biletave sipas destinacionit dhe specifikimeve të kërkuara
- Çertifikatë akreditimi ose një vërtetim nga IATA, që vërteton se operatori ekonomik është i akredituar nga Shoqata Ndërkombëtare e Transportit Ajror (IATA).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë bazuar në nenin 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenin 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Specifikimet janë përcaktuar duke përshkruar të dhënat sasiore, destinacionin, të dhënat teknike që nevojiten për realizimin e shërbimit në përputhje me kërkesat e përcaktuara për realizimin e shërbimit, për të orientuar operatorët ekonomikë që do të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi, me qëllim ofertimin dhe realizimin e objektit të prokurimit. Si dhe çertifikata është e nevojshme për të vërtetuar që operatorët ekonomikë janë të certifikuar për ta realizuar këtë shërbim.